

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8 Sh - 2
L 20

Ferit Lamaj

NË VERË DHE NË DIMËR


vargje humoristike

8 Sh - 7
—
S 20

FERIT LAMAJ

NË VERË DHE NË DIMËR

vargje humoristike



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

S'U ECI GOZHDA MË NË DERRASE

1.

«Pata një hall
një ditë korriku;
s'e zgjidha vetë,
ma zgjidhi miku

Se sot çdo mik
paskérka vlerë,
në daç kasap,
rë daç berber.

Se, fjala bie,
po të jetë mjek
je siguruar,
nuk ke hendek.

Pa hapur sytë
mjek Sokrati
ta nis raportin
për regjim shtrati.

Për pak në klasë
më mbeti djali,
por doli miku
dhe u zgjidh halli.

Thoni të drejtën:
a s'ish mëkat
t'banoja unë
në kat të gjashtë!

Ndërhyri miku,
për bukuri, —
në kat të dytë
banoj tani.

Një mik, një mik,
një mik pér mua:
sa herë e them
aq herë e dua.

Në se ke hall,
shpejt të zgjidh punë,
se ndihm' e mikut
vérshon si lumë.

Prap' sot i qetë
vazhdoj marshimin,
se kam në xhep
rekomandimin.

Rekomandimin
në xhep e kam
aman, shoko,
aman-aman... »

2.


Që atë ditë
ai dhe miķu
pēr fat tē ked
ranë nga fiku.

S'u eci gozhda
mē nē dērrasë;
se vigjelon
te ne një masë.

Doni tē dini
me ta ç'u bë?
Shihni «Hostenin»
nē faqen një.

Hysk' Borobojka
edhe Zefiri
ua qëndisën
o mē së miri.

Se në fejton,
karikaturë
s'u ish dhënë rasti
të dilnin kurrë...



K O N T R A S T

Edhe pse, o xha Gani,
tashmë mbushe shtatëdhjetë,
ti gjithnjë si djal' i ri
mbjell në ar' e drutë pret...

Dhe ndërkohë po mendoj gjatë
për një djalë që kam parë
të ankohej dit' e natë
si të ish... shtatëdhjetëvjeçar.

PAS PASTRIMIT

Që në dhomë të mos mbetej
dhe m'e vogla mbeturinë,
bleve fshesën me korent...
Ty të lumtë, moj Katinë.



Pastërtinë ke në gjak,
mban rekordin në pallat;
dysheme, tavan, dritare
i mban xixë ditë e natë.

Do të çmoja nikoqire
shembullore e të rrallë,
por nuk mund se pas pastrimit
i shtyn plehrat nëpër shkallë...

Kësaj unë i them kështu:
zbardh atje e nxij këtu.

R U B I N E T I

Tek kalon dhjet' herë në ditë
shehi që rrjedh një rubinet,
është i lagjes, s'është yti,
ndaj dhe njërin sy mbyll shpejt.

Ky qëndrim, shoko, s'të shkon.
Po habitem prej çudisë
tek merr pincat dhe shtrëngon
rubinetin e... shtëpisë.

ORË DHE MINUTË

Për kritikë je i pari,
ta qëndis me fije ari —
herë i ashpër herë i butë,
ikën ora si minutë.



Ndërsa për autokritikë
nuk e di pse ke frikë!
Flet ngadalë, flet me zor —
ikën minuta si orë.

S'MBAHEN GJELAT NË PALLAT

Në uzinë shoku Sulë
është i urtë porsi pulë;
cilio që ta shikojë
do të thotë: — Qenka pa gojë.

Në uzinë vërtet nuk flet,
por ta dijë çdo njeri:
në rrebesch edhe tërmët
kthehet Sula në shtëpi.

Përplas krahët që n'agim,
ki-ki-ki këngën fillon;
çirret, shan gruan, fëminë,
këng' e tij çdo ditë jehon.

Dhe një ditë një nga komshitë,
tek dëgjonte shamat,
i thotë gruas: — Ç'është kjo këngë?
S'mbahen gjelat në pallat...

D Ë R R A S A T

Një marangoz ishte qepur pas sasisë,
për cilësinë as që pyeste fare;
katër dërrasa dëm për një kornizë,
njëzet e pesë për katër copë dritat.

U bë një mbledhje ku u ngrit ai.
Më në fund fjalën e mori masa:
— Megjithse ke tepricë, ne bëjmë çudi
se prap' të dalin mangut ca «dërrasa».



UNË, PËR NDER, NUK PATA FAJ

Pash' një vajzë në bulevard,
ish e bukur, ish e gjatë;
ish belhollë dhe syzezë —
zemra flak seç m'u ndez.

E ndaloj dhe i jap dorën
edhe njihem me Lonorën.
U pëlqyem fort, për besë,
ndaj në çast shpallëm fejesë.

Bëm' martesën për dy ditë,
u habitën dhe komshijtë.
Këngë, valle e dolli —
jetë të lumtur, çift i ri!

Për çka ndodhi pas kësaj,
unë, për nder, nuk pata faj
pasi vetë shoqja Lonorë
kérkoi ndarjen bashkëshortore...

SUVAJA E TIJ


Prishet një mur,
një xham seç thyhet,
një suvaturë...
një pemë shqyhet.

Gjithë ky ndryshim,
gjithë ky dëmtim
po ia mbyll sytë
shokut Kujtim

se për atë
ka rëndësi
të mos bjerë
suva e tij.

SEKRETI

Sy si të tutë s'kam parë gjetiu
si të mbyllen vetvetiu
tek prashit atje në arë
dhe s'të hapen as me darë.



Por sekreti i çudisë
është në arën e shtëpisë;
ndonse terr, shoku Mentor,
sytë të kthehen në projektor.

KUR TË TJERË MARRIN ZOTIME

Kur të tjerë marrin zotime,
merr zotime edhe ti:
do të kem kaq tejkalime,
do bëj punë me leverdi...

Kur të tjerët mbajnë zotimet,
ti zotimet nuk i mban;
nisin varg justifikimet...
S'bën kështu, o mik, o xhan!

«KONTROLLI» I... KONTROLLORIT

Nga njëzet soba të prodhuar sipas planit
nëntëmbëdhjetë... skarco iu përcollën dyqanit.
Mbeti një e rregullt në mes të oborrit —
i kishte shpëtuar «kontrollit» të... kontrollorit.

S E L A

Sela paska huq të vjetër:
në çdo mbledhje në një letër
zë shënon pa hapur gojë
kush do flasë, do diskutojë . . .

Po nuk u përmend gjëkund,
nuk ka burrë Selën ta tundë
nga karrigia e t'i thotë:
— Çohu, Selë, e folna sot . . .

Po u prek qoftë dhe një grimë
veç ta shihni, — vetëtimë
të çojë Sela njérën dorë
dhe të flasë nja katër orë.


ËSHTË I THJESHTË DHE ME KULTURË

Është i thjeshtë dhe me kulturë,
modestinë e ka ves;
çdo tipar të mirësjelljes
ia dallon qysh në mëngjes,
qysh kur thembrat me një fjalë
prej shtëpisë t'i kenë dalë...



Ndaj me gisht të gjithë e thonë
dhe, për nder, kanë të drejtë.
Veç kulturë e tij e madhe
sikur tretet shumë shpejt.
... Ndërron pamje menjëherë
sapo vë majat në derë.

FABULA – MIKROFABULA



LAPSI DHE GOMA

Një ditë lapsi i alarmuar
kundër gomës ish lëshuar:
— Kam dëgjuar disa herë
tek të mbajnë si send me vlerë!
Përse vlen, të lutem shumë,
kur ti fshin çka shkruaj unë?

U hodh goma dhe i tha:
— Nuk ke turp, flet badiava!
Ndaj kam vlerë të paarrirë,
pasi fshij çka duhet fshirë.

T H U M B I

Një ditë bletës i thotë grera:
— S'është e drejtë aspak kjo punë,
përse të nderojnë ngahera
kur dhe ti ke thumb si unë?!

Gjegjet bleta: — Ja ndryshimi —
si s'e sheh, moj e uruar —
unë thumboj në rast ngacmimi,
ndërsa ti për të... ngacmuar.

D H E L P R A

Më vjen keq të t'i hedh sytë,
si je nxirë e si je tharë!
Ti që s'njihje një të dytë
tatëpjetën paske marrë.

S'ka më pula si qëmoti,
s'ka më vezë, rosa e rrush;
me kërbaç të pret i zoti,
dhelpërinë s'e ha më kush.

Ndaj kur rrugën këtej kthen,
vështro mirë e hapat mati:
syrin pishë e veshët ngrehur
i mban sot i gjithë fshati.

UJKU DHE QENI

Në një fshat të thellë, diku në malësi,
ujkun e pabesë e vunë bari.
E kulloste ujku deri vonë kopenë
... delet edhe qëngjat na linin shëndenë.

E nuhati qeni edhe tha vetiu:
— Un' ruaj nga ujku, ujk qënka bariu!

Dhe një ditë prej ditësh ujkun e pabesë,
tek e panë që hante mishin e kopesë,
e lidhën, e shpunë drejt në kryesi;
n'emër të kopesë i ngritën padi.

« P R A N I M I »

Dhelpra, kur u zu ngushtë,
pranoi se u gjënd te rrushtë,
por që të kishte ngrënë vetë
s'ishte e vërtetë.

Kishte shkuar këtë herë
vetëm për t'u marrë erë...

FLETA E PEMËS

Prej erës u shkëput
nga pema një fletë.
U tha shoqeve:
— Për ndër, ika vetë . . .


I THANË DHISË

Tek panë cjapin që pinte sisë,
i thanë dhisë:
— Ç'ushqen akoma, moj e shkretë,
një parazit që... s'kullot vetë!

ALLEGORIA

VITI I RI TE BUROKRATI

Vit' i Ri si në çdo derë
dhe në derë të tij shkoi;
si trokiti disa herë
priti ca, pastaj dëgjoi:




«Ka orar a s'ka orar,
gjithë natën zgjuar mbeta!
Nuk pranoj unë qytetarë
kur kalon nga dymbëdhjeta . . .»

TE KOPRACI

Kur e pa Vitin e Ri
që t'i vinte përsëri
pas një viti,
ia priti:

— U mësua keq i shkreti
me raki dhe mish gjeldeti!
Këtë herë do ta bëj zap —
derën kurrë nuk ia hap...




LIBERALI

Vitit të Ri
premtim:
kur të paraqitet rasti,
të vijë t'i bëjë ndonjë lëshim.



S K E P T I K U

Unë them se Viti i Ri
është i ri vetëm në emër
sepse në moshë me siguri
është vazhdues i vtitit të vjetër . . .



I N D I F E R E N T I

Për mua s'ka rëndësi
në je a në s'je ti —
për mua në këtë jetë
mjafton të jem vetë.

NJË LIBRASHITËSJE


Të porosis, shoqja Elvirë,
të jesh e urtë, të sillesh mirë
se ti vazhdon (por deri kur?)
e shet kulturën pa kulturë ...

EDHE NJË HERË

Edhe një herë që më fale diçka personale
m'u qepe nga pas, më mburrje dhuratën.
Unë vonë e kuptova, dhurata kish halle —
tani nuk më shqite as ditën as natën.

NË VERË DHE NË DIMËR

S't'u gjend karari asnjëherë
në punë, në jetë, në shoqëri:
ndërsa në dimër kërkon diell,
në verë kërkon ngaherë shi ...




NJË LLAFOLOGU

Shkasin fletët një nga një,
fjalët rrjedhin lumë.
Ty të lumtë se hëpërhcë
na vure ne në gjumë!...



MENDON QË TË MOS... MENDOJË

Dembeli i ngratë
në mendim kish rënë
e po mendonte gjatë.
Kur se ç'i lindi hëpërhcë
mendimi që të mos... mendonte më.



NJË STUDENTI NË FIZIKË

Nëse dikush nuk vjen në leksion,
ti je i dyti që i vë vizë ...
Edhe këtë na e shpjegon
me ligjin fizik të inercisë ...

SHARKODH

PËRMBAJTJA E LËNDËS

VJERSHA

| | |
|---------------------------------------|----|
| S'u eci gozhda më në dërrasë | 5 |
| Kontrast | 9 |
| Pas pastrimit | 11 |
| Rubineti | 13 |
| Orë dhe minutë | 14 |
| S'mbahen gjelat në pallat | 16 |
| Dërrasat | 17 |
| Unë, për nder, nuk pata faj | 18 |
| Suvaja e tij | 19 |
| Sekreti | 20 |
| Kur të tjerë mbarrin zotime | 22 |
| «Kontrolli» i ... kontrollorit | 23 |
| Sela | 24 |
| Eshtë i thjeshtë dhe me kulturë | 25 |

FABULA – MIKROFABULA

| | |
|----------------------|----|
| Lapsi dhe goma | 29 |
| Thumbi | 30 |
| Dhelpra | 31 |
| Ujku dhe qeni | 32 |

| | | |
|---------------|-------|----|
| «Pranimi» | | 33 |
| Fleta e pemës | | 34 |
| I thanë dhisë | | 35 |

EPIGRAME

| | | |
|-----------------------------|-------|----|
| Viti i Ri te burokrati | | 39 |
| Te kopraci | | 41 |
| Liberali | | 42 |
| Skeptiku | | 43 |
| Indiferenti | | 44 |
| Një librashitësje | | 45 |
| Edhe një herë | | 46 |
| Në verë dhe në dimër | | 47 |
| Një llafologu | | 48 |
| Mendon që të mos... mendojë | | 49 |
| Një studenti në fizikë | | 50 |